

KQZ
U PROTOKOLLUA
NR. 688 PROT
DATE 05 10 2012

Tiranë, më 30.09.2012

Për : Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve

TIRANE

Nga: **Flamur LALO**

Ekspert Kontabël i Regjistruar

Rruga Adem Seit Kruja Nr. 38, pallati Ri, kati 4

TIRANE

Lënda : Informacion lidhur me detyrën e marë prej jush sipas kontratës së shërbimit të datës 28.05.2012.

Zotërinj,

Me ndjenjën më të lartë të detyrës, mora përsipër auditimin e pasqyrave financiare të parive politike për vitin 2011 si më poshtë:

1. **Partia Socialiste e Moderuar.** Mbas shumë kërkimesh, arrita të komunikoj me ekonomisten e kësaj partie (ekonomiste me kohe të pjesëshme) e më pas me zotin Gjergj KOJA, kryetar i kësaj partie. Nga bisedat me ta, por edhe nga deklarata e shkruar, mësova **se kjo parti gjatë vitit 2011 nuk ka pasur në dispozicion asnjë fond.** Ajo nuk ka përpiluar dhe nuk ka dorëzuar pasqyra financiare. Është regjistruar në tatime në datën 21.02.2012 me NUIS (NIPT) L214214531). Gjatë vitit 2011 nuk ka pas çelur as llogari bankare. Atë e ka çelur në datën 19.03.2012 pranë bankës "Tirana Bank".

Në këto kushte, unë nuk pata në dispozicion pasqyra financiare të cilat duhej t'i auditoja. Unë nuk pata as dokumenta të tjerë financiarë si fatura blerje apo mandate arkëtimi e pagese. Pra unë nuk munda të bëj një raport auditimi sipas standarteve të auditimit.

2. **Partia Alternative Republikane.** Kjo parti është themeluar me vendimin e gjykatës nr 14/1 datë 15.01.1993. Pranë gjykatës së Tiranës, gjeta urdhërin e ish Ministrit të Drejtësisë z. Kudret Çela në të cilin **nuk përmëndej as emri i kryetarit të Partisë.** Asnjë informacion tjetër nuk mund të gjej për këtë parti. Pra s'munda të bëj edhe në këtë rast një raport auditimi.



3. **Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres.** Në gjykatën e Tiranës mësova se Partia Lidhja për Drejtësi dhe Progres me kryetar z. Elmaz Sherifi, është krijuar në datën 02.03.2012. **Pra kjo parti nuk ka ekzistuar gjatë vitit 2011 për të cilin unë kishja për detyrë të realizoja auditimin.**

Nisur sa më lart, e konsideroj për detyrë t'ju informoj se megjithse detyrën e mora me shumë kënaqësi (e kishja për herë të parë), unë nuk mund të bëj një auditim në kuptimin e plotë që ka kjo detyrë.

Bashkëlidhur:

- Deklarëtn e z. Gjergj KOJA, kryetar i Partisë Socialiste e Moderuar.
- Urdhërin e Minsitrit për krijimin e partisë Alternativa Republikane.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.



Audituesi i pavarur
Flamur LALO

Nr. Kontakti 069 20 94 715
e-mail: flamurlalo@yahoo.com

DEKLARATE

Unë Gjergj Koja, me cilësinë e kryetarit të Partisë Socialiste të Moderuar deklaroj nën përgjegjësinë time personale se kjo parti gjatë vitit 2011 nuk ka përfituar asnjë donacion nga shteti, persona juridikë, fizikë apo individë. Është kjo arsyeja që edhe NIPT-in (nr.L21421453I) e kemi çelur me vonesë në datën 21/02/2012, llogarinë bankare të Partisë Socialiste të Moderuar e kemi çelur në datën 19/03/2012 pranë bankës Tirana Banke me nr.0180-382038-100.

E lëshoj këtë deklaratë në kudrin e auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2011 që po organizon Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve.

Gjergj KOJA

Kryetar i Partisë Socialiste të Moderuar



REPUBLIKA E SHQIPTERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
DREKTORIA E KODIFIKIMIT

44
U R D H E R
Nr. 144, dt. 10.1.1993

"Per miratimin e formimit te Partise Alternative
Republikane".

Ne Ministria e Drejtësisë janë paraqitur dokumentet nga n komisioni ndasmetar per miratimin e formimit te Partise Alternati Republikane.

Pasi u mbyll me permbajtjen e katyre dokumenteve, konstato ato jane ne perputhje me kerkesat e ligjit "Per dispozitat krye kushtetuese", si dhe te ligjit "Per partite politike".

Prandaj, ne baze te nenit 10 te ligjit nr.7502, dt.25.7.19 "Per partite politike",

u r d h e r o j i

1.Miratimin e formimit te Partise Alternative Republikane, regjistrimin e saj ne regjistrin perkates, si dhe depozitimn e dokumenteve ne arkivin e kesaj ministrie.

2. Nje kopje e kettij urdhuri t'i dergohet komisionit ndasmetar per formimin e kesaj partie.

3.ky urdher hyn ne fuqi menjehere.

MINISTRI
Kudret Çela

